

Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete

Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete (ZKXXX) është mekanizëm mbrojtës në nivel lokal që është i detyrueshëm në komunat ku komunitetet përbëjnë të paktën dhjetë për qind të popullsisë së komunës. ZKXXX është i mandatuar për shqyrtimin e ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve në lidhje me shkelje të të drejtave të tyre përmes akteve ose vendimeve të kuvendit të komunës, dhe është përgjegjës për t'i paraqitur pretendimet e tilla para kuvendit të komunës. ZKXXX mund të kërkojë rishqyrtimin e aktit ose vendimit përkatës. Në rrethana të caktuara, ZKXXX mund t'i drejtohet gjithashtu Gjykatës Kushtetuese dhe t'ia parashtrijë aktet ose vendimet që konsideron se shkelin të drejtat e garantuara me kushtetutë. Në komunat ku popullsia nga radhët e komuniteteve në pakicë numerike arrin pragun prej dhjetë për qind kjo pozitë rezervohet për përfaqësuesin e komunitetit joshumicë që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

Dokumentet kryesore

- Kushtetuta, neni 62(1) dhe (2);
- Ligji për vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040, 2008);
- Udhëzimet për zëvendëskryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete.

Themelimi

ZKXXX-të janë themeluar në 11 komuna.

Dragash	Novobërdë
Fushë Kosovë	Prizren
Gjilan	Shtërpcë
Graçanicë	Zubin Potok ¹
Kllokot	Zveçan ¹
Mitrovicë Veriore ¹	


¹ Mungesa e të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë për këto komuna krijon paqartësi në lidhje me themelimin e kësaj pozite. Prandaj, për qëllime të kësaj analize janë përdorur vlerësimet e numrit të popullsisë në Profilet e komunave të Kosovës të përpiluara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2018. (Gjenden tek <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>)

Qasja në burime financiare

Që të gjithë ZKXXX raportuan pengesa në qasjen në burimet e duhura financiare. Në shumë raste, burimet financiare nuk janë ndarë në mënyrë specifike për funksionin e tyre, ose atyre u duhet të varen nga mbështetja financiare dhe logjistike nga organet e tjera komunale.


Përbërja gjinore dhe përfaqësimi i komuniteteve

Përkatësia e komunitetit të ZKXXX



Gjatë periudhës së raportimit, që të gjithë ZKXXX-të ishin burra.

ZKXXX sipas gjinisë




Performanca në vitin 2020

Treguesit e zgjedhur të performancës

Numri i ZKKKK-ve që ndërmorën aktivitetet kryesore dhe detyrat themelore të përshkuara në kornizën ligjore dhe të politikave, bazuar në monitorimin e rregullt të ekipeve në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe shqyrtimet specifike periodike nga ekipet në terren, si dhe raportet e përgatitura komunitat.

1 - Shqyrtimi dhe referimi i kërkesave për shkelje të të drejtave të komuniteteve me akte komunale


Shqyrtimi i pretendimeve për shkelje të të drejtave të komuniteteve me aktet ose vendimet e kuvendit të komunës



Gjatë periudhës së raportimit, asnjë ZKKK nuk parashtrroi për shqyrtim pretendime për shkelje të të drejtave të komuniteteve në Gjykatën Kushtetuese.


2 – Promovimi i dialogut ndërmjet komuniteteve

Angazhimi në aktivitete për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve




3 – Raportimi

Ofrimi i informatave te organet tjera komunale lidhur me aktivitetet dhe punën e tij




4 – Bashkëpunimi:

Pjesëmarrja në mbledhjet e komitetit për komunitete




Bashkëpunimi në shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve



5 - Komunikimi dhe konsultimi

Lehtësimi i përfshirjes së komuniteteve në punën e kuvendit të komunës



■ Po ■ Jo

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSCE) ofron mbështetje për përmirësimin e pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset e vendimmarrjes e qeverisjes, si dhe në institucione. Në suazat e këtyre përpjekjeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë e monitoron rregullisht punën e mekanizmave komunalë për mbrojtjen e komuniteteve. Këto fletushka informuese kanë si qëllim t'u ofrojnë institucioneve përkatëse tregues që mund t'u ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.